



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 2-të të Komitetit për Komunitete të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 11.03.2026, në sallën nr. 2 në katin e tretë me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Alush Bikliqi, kryesues
2. Gentianë Hoxhaj , anëtare
3. Hyra Bytyqi, anëtare
4. Shahadije Bikliqi Dragaçina, anëtare
5. Yllëza Bedrolli, anëtare
6. Slavisa Trajkovic, anëtar
7. Maksut Gashi, anëtar,
8. Zoran Cirkovic, anëtar
9. Ollga Guciq, anëtare
- 10.Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

- 1.Naser Bytyqi, përkthyes shqip-serbisht
2. Përfaqësues i UNMIK-ut

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu,**

Kryesuesi i Komitetit Alush Bikliqi, pasi i përshëndeti të pranishmit, tha se ftesën me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim:

REND DITE

- 1.Diskutimi dhe aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për Vitin 2026
- 2.Të ndryshme

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Meqë askush nuk u lajmërua për fjalë, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit konstatoi se Komiteti për punën e kësaj mbledhje unanimisht aprovoi këtë:

Pastaj u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Diskutimi dhe aprovimi i planit të punës së Komitetit për Komunitete për Vitin 2026

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes, Alush Bikliqi tha se materialin e bashku me draft planin i keni marr me kohe dhe pyeti anëtarët e Komitetit, se a ka dikush ndonjë propozim për plan të punës.

Unë tha kam propozim që raporti i ZLK-se, të mos jetë çdo muaj por të jetë çdo 2 ose 3 muaj.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin.

Shahadije Bikliqi Dragaçina, tha se unë jam që raporti i ZLK-së të mos jetë çdo muaj por çdo 2 muaj.

Gentiane Hoxhaj, tha se unë nuk pajtona me juve pasi që mendoj që me mirë do të ishte të na raportonin çdo muaj ZLK-ja.

Hyra Bytyçi, tha se unë mendoj që duhet të jete ZLK-ja, çdo muaj që ta na informoj rreth aktiviteteve dhe punëve të tyre.

Fehmi Rexhepi, tha pajtona edhe unë me parafolësit që çdo muaj të raportoj ZLK-ja, pasi që komunitetet kanë nevojë me shume për ndihmë tone dhe ne duhet të punojmë për ta.

Zoran Cirkovc, tha se edhe unë pajtona që të jete ZLK-ja çdo muaj sepse jemi me shume të informuar për rastet në teren.

Alush Bikliqi, kryesues i komitetit tha se pasi që shumica jeni që të jete ZLK-ja, çdo muaj ashtu po e vendosim.

Pastaj nga anëtarët e komitetit u dhanë edhe disa rekomandime dhe ndryshime të plani i punës së Komitetit për Komunitete të cilin do ta gjeni të bashkangjitur me Ekstrat

SHTOJCË:

PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIT 2026

Muaji	Aktivitetet	Data e takimeve
JANAR	<p>Shqyrtimi, analiza dhe aprovimi i Raportit vjetor të punës dhe aktivitetit të Komitetit për Komunitete për vitin 2024</p> <p>Faktorët ndikues për mos përmbushjen e kërkesave të komuniteteve gjatë vitit 2024</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	(Sipas rrethanave dhe marrëveshjes)
SHKURT	<p>Ftese drejtorisë se bujqësisë për informimin rreth mundësitë se subvencionimeve tek fermerët.</p> <p>Ftese drejtorisë se kulturës, rinise dhe sportit për informimin rreth mundësitë se subvencionimeve për kulture, rini dhe sport</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	(Sipas rrethanave dhe marreveshjes)
MARS	<p>Te ftohet drejtori e drejtorive te sherbimeve publike</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	(Sipas rrethanave dhe marrëveshjes)
PRILL	<p>Të ftohet Drejtori i Shëndetësisë qe te raportoje për qasjen e shëndetësisë tek komunitetet.</p> <p>Informatë nga Qendra Për Pune Sociale për numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali, Egjyptas, Kroate, Serbe dhe Rome.</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.
MAJ	<p>Informatë nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim</p> <p>Informatë nga Drejtorati për Infrastrukturë Publike</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.

QERSHOR	<p>Ftohet zyrtari kryesor financiar qe te raportoje per Kornizën komunale bugetore – Shqyrtimi i mundesise per ndarjen e buxhetit për ndihme komuniteteve dhe planet rreth infrastrukturës neper vendet ku komunitetet jetojnë.</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.</p>
KORRIK	<p>Te ftohen drejtori drejtorisë së infrastrukturës për një informatë rreth punimeve qe po zhvillohen ne teren</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.</p>
GUSHT	<p>Vizitë te vendbanimet ku jetojnë komunitetet</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.</p>
SHTATOR	<p>Zyrtari për buxhet dhe financa te raportoje për aprovimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. A ka ndonjë propozim nga komunitetet qe është përfshirë ne planifikimin e buxhetit. Te raportohet për rregulloren e tatimin ne prone?</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.</p>
TETOR	<p>Informatë nga DKA-ja për fillimin e vitit shkollor</p> <p>Zyra për komunitete te informoje rreth aktiviteve mujore te zyrës apo çështjeve/kërkesave te komuniteteve</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.</p>
NËNTOR	<p>Vizitë ku banojnë komunitetet</p>	<p>Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit</p>

DHJETOR	Shqyrtimi dhe aprovimi i planit të punës si dhe arritja e marrëveshjes për orarin e takimeve më 2027 Zyra për komunitete të informoje rreth aktiviteteve mujore të zyrës apo çështjeve/kërkesave të komuniteteve.	ZKKK. Komiteti për Komunitete; Ministria e Kthimit; Kryesuesi i Kuvendit ZKKK.
----------------	--	---

Pastaj u kalua në pikën e dytë të rendit të ditës.

II

Të ndryshme

Zoran Cikrovic, tha unë do ta ngris një shqetësim të timin dhe qytetarëve ka të beje me qentë endacak që është një shqetësim shumë mi madh dhe po jemi të rrezikuar të gjithë ku nuk po guxojnë me dal as ne oborr prej tyre.

Alush Bikliqi, kjo çështje është diskutuar shumë here edhe në KKSB dhe me ekzekutivin por nuk po mujna me bo zgjidhje pasi që është si duket problematik e të gjitha komunave.

Fehmi Rexhepi, tha se unë do ta ngris një shqetësim të komunitetëve që unë përfaqësoj në Medvec të cilët po përballen me kushte të renda ekonomike, po detyrohen dhe fëmijët ta braktisin shkollimin shkaku i kushteve të renda a ka mundësi me ju ndihmuar këtyre familjeve.

Meqë çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11¹⁵.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu
Zyrtar Ligjor

Kryesuesi i Komitetit

Alush Bikliqi